



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 219, datë 31.10.2018

PËR
MIRATIMIN E SHITESËS SË FONDIT TË KOMPENSIMIT

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe pikës 3 dhe 4 të nenit 45, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

KONSTATOI SE:

Në bazë të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, neni 45 “shoqëritë e sigurimit, të cilat ushtrojnë veprimtari në territorin e R.SH. në sigurimin e detyrueshëm motorik, janë të detyruara të kontribuojnë çdo vit financiarisht në fondin e kompensimit, në përpjestim të drejtë, me primet bruto të shkruara në këto lloj sigurimesh, në vitin paraardhës”.

Autoriteti, me propozim të Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve, sipas pikave 2 e 3 shkronja b dhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet derdhja.

Gjithashtu burime të tjera të fondit të kompensimit sipas pikës 3 të nenit 45 është dhe kontributi shtesë i shoqërive të sigurimit kur fondi i parashikuar rezulton të jetë i pamjaftueshëm për të kryer pagesat e dëmeve.

Byroja Shqiptare e Sigurimit me shkresën nr. 5997 prot., datë 17.10.2018, ka depozituar për miratim vendimin nr. 21, datë 11.10.2018 “Për miratimin e shtesës për fondin e kompensimit për vitin 2018”.

Sipas këtij vendimi, është propozuar shtesë e fondit të kompensimit për vitin 2018, për pagesën e detyrimeve të fondit të kompensimit në vlerën 274,421,905 lekë.

Vlera e kësaj shtese i korrespondon vlerës së praktikave të shpërndara, për ngjarjet deri 31.12.2013, sipas vendimit të APA të BSHS-së nr. 14, datë 15.08.2018.

Ky vendim është firmosur nga shumica e anëtarëve të BSHS-së.

Në pikën 3 të këtij vendimi, citohet se pagesa e dëmeve objekt i fondit të kompensimit do të fillojë gjatë vitit 2018 dhe do të shtrihet gjatë vitit 2019.

Përsa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Bazuar në nenin 45, pika 4, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, miratohet shtesa e fondit të kompensimit për vitin 2018, sipas propozimit të BSHS-së në vlerën 274,421,905 lekë.
2. Të urdhërohet Byroja Shqiptare e Sigurimit të llogarisë vlerën respektive për çdo shoqëri sigurimi të kësaj shtese.
3. Shoqëritë e sigurimit, pavarësisht shtrirjes së pagesës të praktikave, duhet të pasqyrojnë në pasqyrat financiare të vitit 2018, vlerën korresponduese të kësaj shtese, të përcaktuar sipas pikës 2 të këtij vendimi.
4. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI